



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:081910

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05587726

P.nr.201/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me zyrtares ligjore Doruntina BEKA, në çështjen penale kundër të pandehurës D.A. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 4 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.143/23 (2023:0008620) të datës 03.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 17.04.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, e pandehura D.A. dhe mbrojtësit të saj sipas autorizimit me shkrim, avokat Isa Hyseni, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.04.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D.A., nga i ati I., e ëma E., e vajzërisë V., e lindur me datë në Mitrovicë, me vendbanim në lagjen T.. Hyrja nr., kati i 3 nr..., e martuar, e pa punë, me numër personal, ka të kryer shkollën e fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 26.08.2022, rreth orës së pa përcaktuar në Mitrovicë, duke vepruar me dashje me qëllim të ngacmimit përmes komunikimit/postimit në rrjetin social “Tiktok”, e vë në shqetësim të madh emocional të dëmtuarin M.S.-M, në atë mënyrë që i dëmtuari ka qenë në lidhje dashurie më të pandehurën dhe e njëjta më përfundimin e kësaj lidhje, ka postuar fotografi në rrjetin social “Tiktok” ku shihet i dëmtuari se bashku më të dashurën e tij, këto fotografi ajo i kishte dërguar tek të afërmit e tij, e me të cilat veprime i shkakton të dëmtuarit shqetësim të madh emocional.

Me këtë ka kryer veprën penale: Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 e lidhur me nenin 182 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Obligohet e pandehura që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi
- III. I dëmtuari M. S. M., për realizmin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr. 143/2023 të datës 03.04.2023, kundër të pandehurës D.A., për shkak të veprës penale: Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me par.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 17.04.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Arjan Xhema, e pandehura D.A. dhe mbrojtësi i saj sipas autorizimit me shkrim, avokat Isa Hyseni.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, e pandehura ka deklaruar se e ndjen veten fajtores për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë, e njëjta kërkon falje, thekson se më nuk ka pasur probleme e madje as kontakt me të dëmtuarin dhe lutë gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, gjykatës i ka propozuar që të pandehurën ta shpallë fajtores, ta dënoj sipas ligjit duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Mbrojtësi i të pandehurës D.A., avokat Isa Hyseni në shqyrtim fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se e mbrojtura e tij pranimin e fajësisë e ka bërë në baza vullnetare dhe pas konsultimit me të si mbrojtës dhe i propozon gjykatës që ta aprovoj të njëjtin, ndërsa sa i përket sanksionit penal i propozon gjykatës me rastin e caktimit të llojit dhe

lartësisë së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese si: çështjet personale se e njëjta tashmë e ka rregulluar jetën bashkëshortore, është martuar, gjendja e dobët ekonomike, e pa punë, keqardhjen e shprehur dhe sjelljen e saj pas kryerjes së veprës.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar e akuzuara, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurën. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Shënimi zyrtar, datë 22.09.2022, raporti i policit B.H. #.. i datës 26.08.2022, procesverbali i marrjes në pyetje në polici i të dëmtuarit M.S., i datës 26.08.2022, procesverbali i marrjes në pyetje në polici i të pandehurës D.A., e datës 23.09.2022, CD-nga i dëmtuari, e kaluara kriminale e të pandehurës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se e akuzuara ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurat është bërë në mënyrë vullnetare dhe se i pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurës se pas pranimit të fajësisë, ajo nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurat dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehura, me veprimet e tij, ka kryer veprën penale: Ngacmim nga neni 182 paragrafi.1 lidhur me par.4 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rënduese në këtë rast, gjykata nuk ka gjetur, ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurës në gjykatë si dhe keqardhjen e shprehur në gjykatë, rrethanat personale të cilat kanë të bëjnë me faktin se e njëjta tashmë është martuar si dhe faktin se për të njëjtën, nuk kishte prova se është zhvilluar ndonjë procedurë tjetër penale për ndonjë rast.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim të kushtëzuar, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurat. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen e pandehura të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket pikës III të dispozitivit gjykata ka vendosur në bazë të nenit 462 të KPP-së, kjo për shkak se nga shkresat e lëndës, gjykata nuk kishte të dhëna lidhur me dëmin e shkaktuar, përkatësisht natyrën e dëmit por as për vlerën e dëmit eventual të shkaktuar.

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.201 /2023, datë 18.04.2024

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.